

*buletini*info

Buletin informativ mujor
Korrik, 2022



PËRKRAHJE FINANCIARE PËR STUDENTËT

QEVERIA për Familjet

Mundësi punësimi përmes
programit të Qeverisë
“Qeveria për Familjet”



Instrumenti për investime
kapitale – CIF



Këndvështrim i historianit
Hakif Bajrami lidhur me
identitetin Egjiptian



PËRKRAHJE FINANCIARE PËR STUDENTËT EGJIPTIAN, ASHKALI DHE ROM PËR TË STUDIUAR NË FAKULTETIN E EDUKIMIT

Me datën 08.07.2022, Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, bashkë me Ministren e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka vizituar qytetin e Pejës, me qëllim të promovimit të mundësisë për bursa për studentë të komuniteteve egjiptianë, ashkali dhe rom për të studiuar në Fakultetin e Edukimit.

Kohë më parë është nënshkruar edhe Memorandumin e Bashkëpunimit për ofrimin e ndihmës financiare për studentë në të gjitha universitetet publike të Republikës së Kosovës.

Tashmë është formuar Grupi i përbashkët koordinues për promovimin e edukimit në arsimin e lartë tek komunitetet ashkali, egjiptianë dhe rom, i përbërë nga përfaqësues të MASHTI, MAPL dhe Shoqërisë Civile.

Ministri i MAPL-së ka përmendur kushtet e vështira me të cilat ballafaqohet një pjesë e madhe e këtyre komuniteteve, duke theksuar se mbështetja financiare i motivon ata që të ndjekin dhe përfundojnë studimet në universitetet publike. Po ashtu, Ministri Elbert Krasniqi theksoi rëndësinë që ka përfshirja në mësimdhënie e komuniteteve ashkali, egjiptianë dhe rom.



Takim i Ministrit Elbert Krasniqi, Ministrës Arbrije Nagavci me përfaqësues të shoqërisë civile

Ministrja Nagavci theksoi se gjithëpërfshirja dhe cilësia në arsim janë prioritet dhe në MASHT po punohet me përkushtim në këtë drejtim. Ajo theksoi se përmes përkrahjes që rrjedhë nga Memorandumi do të sjellim përfitime afatgjata për gjithë shoqërinë pasi kjo do të kontribuonte në krijimin e kuadrit me kualifikim të lartë nga këto komunitete dhe gjithashtu në rritjen e nivelit arsimor në komunitetet përkatëse.

Ministri Elbert Krasniqi bashkë me Ministren Nagavci zhvilluan një takim me kryetarin e Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, me të cilin biseduan për gjendjen në arsimin e kësaj komune, veçanërisht për bashkëpunimin mes nivelit qendror dhe lokal, me qëllim të përmirësimit të kushteve për arsimimin e grupeve të marginalizuara.

Në fund, të dy ministrat kanë vizituar edhe shkollën “Xhemajl Kada” në Pejë, ku kanë takuar nxënës të komuniteteve që ndjekin mësimin intenziv dhe prindërit e tyre. Së bashku me nxënësit dhe prindërit e tyre ata biseduan për rëndësinë që ka arsimi për të ardhmen e fëmijëve të tyre dhe për një jetë më të mirë për të gjithë.



Takim i Ministrit Elbert Krasniqi, Ministrës Arbrije Nagavci me Kryetarin e komunës së Pejës z.Gazmend Muhaxheri



Takim i Ministrit Elbert Krasniqi, Ministrës Arbrije Nagavci me mësimdhënës dhe nxënës të Shkollës Filllore "Xhemajl Kada" në Pejë

INSTRUMENTI PËR INVESTIME KAPITALE – CIF



Në kuadër të programit – Instrumenti për Investime Kapitale - CIF, Ministri i MAPL-së, z.Elbert Krasniqi me Kryetarin e Komunës së Pejës z. Gazmend Muhaxheri dhe Kryetarin e Komunës së Istogut, z. Ilir Ferati, me datën 04.07.2022, kenë nënshkruar Marrëveshjet e Mirëkuptimit për bashkëpunim ndërkomunal për projektin “Zhvillimi i infrastrukturës rrugore dhe bujqësore për komunat Istog dhe Pejë”, në vlerë prej 366.872,31€, nga të cilat bashkëfinancon MAPL në vlerën prej 238.467,00€ dhe komuna lidere, Komuna e Istogut bashkëfinancon në vlerë prej 64.202,50€ dhe komuna partnere, Komuna e Pejës bashkëfinancon në vlerën prej 64.202,50€.





Në të njëjtën ditë, ministri Elbert Krasniqi, në kuadër të programit të njëjtë, me Kryetarin e Komunës së Obiliqit z. Xhafer Gashi kanë nënshkruar Marrëveshjet e Mirëkuptimit për financimin e projekteve kapitale nga “Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndërkomunal” në vlerë prej 135.390,25 nga të cilat MAPL bashkëfinancon në vlerë prej 100.000,00€ dhe Komuna e Obiliqit në vlerë prej 35.390,25€.





Me datën 13.07.2022 Ministri Elbert Krasniqi ka nënshkruar Marrëveshjet e Mirëkuptimit me Kryetarin e Komunës së Klinës z. Zenun Elezaj për bashkëpunim ndërkomunal për projektin “Rregullimi i trotuarit dhe shtegut të biçikletave me infrastrukturë përcjellëse nga Qyteti i Klinës deri te udhëkryqi Pejë-Prishtinë”, vlera e projektit është 375,000.00€ bashkëfinancimi nga MAPL është në vlerë prej 130.000,00€, ndërsa nga komuna për vitin 2022 vlera është 100.000,00€ dhe për vitin 2023 vlera e projektit është 145.000,00€.



Po ashtu me 13.07.2022, ministri Elbert Krasniqi ka nënshkruar Marrëveshjen e Mirëkuptimit me Kryetarin e Komunës së Shtimes z. Qemajl Aliu për bashkëpunim ndërkomunal për projektin “Rregullimi i parkut në fshatin Davidoc”, vlera e projektit është 174.966,02€, bashkëfinancimi nga MAPL është në vlerë prej 113.727,52€, ndërsa nga komuna vlera e projektit është 61.238,10€.





Në të njëjtën ditë, Ministri Elbert Krasniqi ka nënshkruar Marrëveshjet e Mirëkuptimit me Kryetarin e Komunës së Kamenicës z. Kadri Rrahimaj dhe Kryetaren e Komunës së Novobërdës z. Saša Milošević për bashkëpunim ndërkomunal për projektin "Lugu i verdhë /Green valley", vlera e projektit është 399.960,40€, MAPL bashkëfinancon vlerën prej 299.960,40€, Komuna e Kamenicës vlerën prej 98.000,00€ dhe komuna e Novobërdës vlerën prej 2.000,00€.





Me 13.07.2022, Ministri Elbert Krasniqi me Kryetarin e Gjilanit z. Alban Hyseni, ka nënshkruar Marrëveshjet e Mirëkuptimit për projektin 'Parku Baja' i cili do të jetësohet gjatë këtij viti në vlerë prej 249,989.50€.



Me datën 28.07.2022, Ministri Elbert Krasniqi në Komunën e Lipjanit ka nënshkruar marrëveshjet e mirëkuptimit me Kryetarin z. Imri Ahmeti në kuadër të programit CIF. Projekti "Rregullimi i hapësirave publike në komunën e Lipjanit", ka vlerë 139.232.00€.



Me datën 29.07.2022, Ministri Elbert Krasniqi, në Junik ka nënshkruar Marrëveshjet e Mirëkuptimit me Kryetarin e Komunës së Junikut, vlera e projektit është 74.932,00€, prej tyre MAPL bashkëfinancon vlerën prej 50.000,00€, ndërsa Komuna e Junikut vlerën prej 24.932,00€.



Po me 29.07.2022, Ministri Krasniqi në Mamushë ka nënshkruajtur Marrëveshjet e Mirëkuptimit me Kryetarin e Komunës së Mamushës z. Abdülhadi Krasniç, vlera e projektit është 65.600,00€, prej tyre MAPL bashkëfinancon vlerën prej 45.000,00€, ndërsa Komuna e Mamushës vlerën prej 20.600,00€.



Në të njëjtën datë, Ministri Elbert Krasniqi, në Komunën e Rahovecit ka nënshkruar Marrëveshjet e Mirëkuptimit me Kryetarin e Komunës së Rahovecit z. Smajl Latifi, vlera e projektit është 174.519.05€, bashkëfinancimi nga MAPL është në vlerë prej 100.000,00€, ndërsa nga komuna vlera është 74.519.05€.



Në Rahovec, Ministri Krasniqi bashkë me kryetarin Smaj Latifi ka vizituar edhe lagjen e Komunitetit ku MAPL ka investuar në projekte infrastrukturore dhe kuzhinën humanitare 'Te Xhela' përfituese nga masa 3.4.



Me 29.07.2022, Ministri Elbert Krasniqi, me Kryetarin e Suharekës, z. Bali Muharremaj ka nënshkruar Marrëveshjet e Mirëkuptimit, vlera e projektit është 175.000,00€, prej tyre MAPL bashkëfinancon vlerën prej 100.000,00€, ndërsa Komuna e Suharekës vlerën prej 75.000,00€.



Ministri bashkë me kryetarin Muharremaj ka inaguruar projektin për lojërat e fëmijëve dhe ka vizituar vendin ku do të ndërtohen disa shtëpi për familje nga komunitetet.



QEVERIA **për Familjet**

Aplikoni për skemën **”Qeveria për Familjet”**

**për punësim afatgjatë për punëkërkesit që nuk kanë
asnjë anëtar të familjes të punësuar**

Kushtet që duhet ti plotësoni:

- 1. T'i përkasin grup moshës 18-64 vjeç;*
- 2. Të mos kenë asnjë anëtar të bashkësisë familjare të deklaruar si të punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK);*
- 3. Të jenë të regjistruar si të papunë/punëkërkes në APRK.*

Dokumentet për aplikim:

- 1. Kopja e letërnjoftimit;*
- 2. Kopja e diplomës/certifikatës së nivelit më të lartë të edukimit;*
- 3. CV-ja.*

**Aplikimi bëhet në Agjencinë për Punësim
në komunën e juaj.**

Aplikimi ka filluar me 18 Korrik 2022.



KUSH JANË SHQIPTARO-EGJIPTIANËT ALBANOFON NË BALLKAN?

Prof. HAKI BAJRAMI

Përgjigjes në këtë pyetje që është shkruar këtu para jush është e vështirë t'i përgjigjesh aq më parë kur për dhjetë minuta duhet të themi diçka, moti nuk jam frikuar kështu që nuk mund të them asgjë. Megjithatë mendimi shkencor dhe etika shkencore nuk guxojnë të ndalen dhe këtë temë duhet ta shtrojmë guximshëm dhe pa u ndalur. Kolektivi ynë këtu për pak minuta do të orientoj në zgjidhjen e këtij problemi sa problematik aq edhe human por edhe largpamës. Ne sot kemi shumë shtresime edhe në Ballkan edhe etnike edhe kombëtare edhe politike dhe interesash të ndryshme sa që shumë entitete nuk e din ka t'ja mbajnë.

Unë mendoj se akademik dhe institucionet shkencore në këtë drejtim duhet të jenë shumë të ndërgjegjshme aq më par kur në këtë drejtim mendoj dhe ju ftoj që me guxim të organizoheni ta ndani punën ti ndani funksionet dhe ti përgjigjeni vetëdijeve të sinqerta pa ekuivoke pa urrejtje.

Nëse këtë e evitojmë që në fillim suksesi pa dyshim do të jetë fatlum dhe do të jetë faqebardhë, ashtu siç duam të gjithë. Për ta kuptuar këtë temë unë dua që t'ju drejtoj që në hulumtimet që duhet bërë shkencore nëpër arkiva. Mos mendoni në ato hulumtimet e mija sepse nuk kam mundur t'i hasi këto elemente në fonde shtetërore. Mos harxhoni kohë në fondet të cilat i kanë krijuar institucionet e shtetit por të orientojeni në të ashtuquajturat koleksione arkivore dhe konkret ku ta gjeni fillimin, një dritë në fund të tunelit.

Do t'ju drejtoj me një sinjeritet më të madh që ta hulumtoni fondin e Milan Shudvaj një ndër njerëzit më të mëdhenj të medievizmit dhe historisë në përgjithësi natyrisht duke u thirr edhe në literaturën që profesorët tanë më të vjetër kanë hulumtuar pak a shumë në këtë drejtim.

Ju orientoj që të hulumtoni në arshivën e Stambollit fondin lenleshimes një ndër patriotët, shkencëtarët dhe politikanët më të mëdhenj shqiptar.

Ali Shima ishte jo vetëm patriot por ishte njeriu më i gjallë nga penda në Perandorinë Osmane edhe pse ai në klubin e tij e shkruante Shqiptari dhe i turrte shqiptarët që të mos bëhen osmanli, mos të bëhen xhonturq, mos të bëhen diçka çka nuk janë por ta quajnë veten shqiptar. Edhe ju mos u turpëroni por më guxim mbanë këtë qëndrim dhe trashëgoni ashtu si duhet sepse vetëm në atë drejtim e tregoni dinjitetin e juaj edhe para civilizimit edhe para popullit edhe para zotit.

Përpos fondit të Ali Shimës ju udhëzoj që të hulumtoni edhe fondin e Nikol Ivanov fondi i të cilit gjendet në Cetinje, me kujdes, me seriozitet në fondin e tij do të gjeni shumë elemente shtresor të kombeve dhe të laramanive të ndryshme që ka pas jo vetëm kjo trevë por i tërë Ballkani. Jo vetëm ky por hulumtojeni me kujdes punën e Sami Frashërit nga viti 1897-1898 për arsye se, në këtë periudhë, një ndër artistët më të mëdhenj siç ishte Dr. Vlladani u orientua që ti likuidoje të gjithë ata popuj që kanë orientime tjera dhe që nuk duan të mësojnë në gjuhën serbe.

Mandej nuk është zor që ta hulumtoni fondin e njërit prej njerëzve më të ngarkuar me shovinizëm Jovan Hadjivasilevic sepse duhet të mësoni edhe prej atij që ju urren edhe prej atij që ju donë më shumë druani nga ai se nga ai që iu urren nëse organizoheni. Është një fond i Qamil Pashës në Stamboll, ky ka qenë edhe kryeministër, ai njeri kishte një orientim të gjerë, kishte një dituri të gjerë, ky njeri ka qenë ai më fatlumi që e ka njohur edhe Kemal Ataturkun një njeri shumë i madh por edhe Ali Shefqet Shkupin i cili u bë një ndër komandantët e parë të ushtrisë shqiptare që njeherit ishte edhe intelektual i shquar me gradë gjeneral që nga viti 1913 deri më 1953. duhet të ju them se duhet ta studioni edhe fondin e Jovan Ristic i cili ishte prezent në Kongresin e Berlinit për arsye se në vitin 1876 në Berlin u prezantua një hartë linguistike prej të cilës pastaj kanë dalë 12 harta linguistike shumë të mëdha por në të cilën janë sublimuar 24 harta linguistike të cilat flisnin për viset etnike shqiptare. Me këtë unë mendoj se do ta mbani në dorë një dritë dhe ajo dritë do të na ndihmojë shumë sepse rruga shkencore gjithmonë është e terravtë dhe në këtë drejtim të shkojmë përpara në drejtim të siç e keni venë aty me sinjeritet të madh "Egjiptiano-Shqiptar" dhe në atë rrugë nëse vazhdojmë kështu nuk ka asnjë forcë që na ndal.

buletini info

Kontriboni me shkrimet e juaja autentike si:

Opinione

Kulturë

Histori

Shkencë

Dërgoni në email: buletini.info@gmail.com